



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

RAPORT MUJOR I MONITORIMIT TË AKTIVITETIT TË KQZ *Shkurt 2021*

Publikuar në datë 25 Mars 2021

Projekti:

“Unë marr pjesë! Zëri im, vota ime vlen” mbështetur financiarisht nga Bashkimi European.

Ky raport u prodhua në kuadër të nismës “Unë marr pjesë! Zëri im, vota ime vlen” mbështetur financiarisht nga Bashkimi European. Përmbajtja e tij është përgjegjesi vetëm e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit European.



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



ISP
INSTITUTE FOR POLITICAL STUDIES
www.isp.com.al



CIVIL
RIGHTS
DEFENDERS

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), në përmbushje të misionit të tij dhe kryerjes së monitorimit të Zgjedhjeve Parlamentare të 25 Prillit 2021, është i angazhuar në vëzhgimin dhe monitorimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe organeve përbërëse. Më poshtë, parashtrohet përmbledhja e monitorimit të kryer gjatë periudhës Shkurt 2021.

Përmbledhje Ekzekutive

Në fokus të monitorimit të KShH-së përgjatë muajit shkurt kanë qenë disa vendimmarrje të rëndësishme të KQZ-së, duke u ndalur në mënyrë të veçantë tek aktet me karakter normative, disa nga sanksionet e vendosura nga KQZ si dhe administrimi i procesit parazgjedhor për votën e emigrantëve.

1. Në datë 30.01.2021, Komisioni Rregullator ka miratuar Vendimin nr. 2 për *“Miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive”*. KShH vëren se në kuadër të kushteve dhe rrethanave të pazakonta në të cilat po zhvillohet procesi zgjedhor për shkak të kufizimeve dhe ri-organizimit të formave të ndërveprimit si pasojë e pandemisë globale Covid-19, nevojitet interpretim i saktë i fushëveprimit të vëzhgimit mediatik nga ana e KQZ-së në mënyrë që të ketë vëmendje dhe ndaj përmbajtjes së mediave alternative, përfshirë platformat e mediave sociale. Media sociale, sa vjen dhe po përdoret në masë të gjerë nga përfaqësues të subjekteve zgjedhore për promovimin e veprimtarive të natyrës propagandistike zgjedhore, video, takime dhe foto me elektoratin, etj. *De facto*, fushata zgjedhore rezulton se ka filluar para afatit të parashikuar në nenin 77 të Kodit Zgjedhor (*një muaj para datës së zgjedhjeve*). Në këtë kuptim, interpretimi i ngushtë se çfarë do të konsiderohet media dhe përjashtimi i medias sociale nga ky fushëveprim, cenon garën e ndershme dhe të barabartë si dhe integritetin e e procesit zgjedhor.
2. Në datë 02.02.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miratoi Udhëzimin nr. 1 për *“Caktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit”*. Monitoruesit e fushatës zgjedhore duhet të ishin emëruar 6 muaj para datës së zgjedhjeve, përkatësisht në dt.25 Tetor të vitit të kaluar, por ngritja e KQZ-së së re në fillim të këtij muaji, pamundësoi respektimin e këtij afati ligjor. Megjithatë, miratimi i këtij udhëzimi mund të ishte menaxhuar më herët në kohë nga KQZ. KShH rekomandon të procedohet me ritme më të përshtatshme për të finalizuar procesin e përzgjedhjes së vëzhguesve me qëllim zhvillimin e monitorimit përgjatë periudhës së fushatës zgjedhore, i cili, sipas akteve të publikuara në faqen e KQZ-së, rezulton të ketë përfunduar në mënyrë të pjesshme vetëm për qarkun e Tiranës dhe të Gjirokastrës, deri në fund të muajit Shkurt të këtij viti.
3. Në përputhje me përcaktimet dhe afatet kohore e parashikuara në nenin 64 të Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar kërkesat përkatëse dhe ka regjistruar si subjekte zgjedhore për Zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, 46 parti politike.



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



Gjithashtu, ka miratuar ngritjen e 8 komiteteve nismëtare për paraqitjen e kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore të Qarkut Shkodër, Berat, Tiranë, Dibër, Lezhë dhe Gjirokastrë.

4. Realizimi i votimit për shtetasit Shqiptar që kanë vendbanim të përhershëm jashtë rezultojnë një proces i vështirë dhe delikat. Paavarësisht se u prezantua si risi në Kodin Zgjedhor në kuadër të reformës zgjedhore që u miratua vitin e kaluar, ushtrimi i të drejtës së votës nga jashtë për diasporën shqiptare nuk është rregulluar në mënyrë të plotë dhe të qartë në dispozitat e reja të këtij Kodi, çka e bën të vështirë zbatimin e saj në praktikë nga KQZ, e cila nuk mund të marrë tagrat e pushtetit legjislativ. Problematikë tjetër është dhe mos evidentimi në Regjistrin e Gjendjes Civile të adresave të vendbanimit të përhershëm të shtetasve shqiptar jashtë vendit, një kriter thelbësor për të mundësuar realizimin e ushtrimit të së drejtës së votës sipas Kodit Zgjedhor. Megjithatë, KShH inkurajon KQZ-në që të marrë masat e nevojshme, bazuar në Kodin Zgjedhor, për të jetësuar, për aq sa është e mundur, këtë proces në praktikë.
5. KShH vlerëson se platformat informuese apo mediatike të rrjeteve sociale nuk duhet të qëndrojnë jashtë vëmendjes së KQZ-së, për qëllim të monitorimit të sjelljes dhe veprimtarisë së institucioneve shtetërore dhe titullarëve të tyre. Përfshirja e medias sociale në përkufizimin e gjërë të medias mbështetet dhe nga raporti përfundimtar i misionit të OSBE/ODIHR për vëzhgimin e Zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2017, në të cilin vëren se *televizioni (TV) është burimi kryesor i informacionit politik, ndërsa portalet online dhe media sociale po e zëvendësojnë me shpejtësi median e shkruar*. Vlerësohet se institucionet dhe organet përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor duhet t'i përgjigjen përshtatshëm rrethanave dhe realitetit në të cilin zhvillohen ky proces, bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare dhe rekomandimet e marra nga OSBE/ODIHR, i cili në vëzhgimin e zgjedhjeve të fundit për Kuvend ka përfshirë median sociale në fushëveprimin e vëzhgimit të medias.



Përgjatë muajit Shkurt 2021, Komiteti Shqiptar i Helsinkit është angazhuar në vlerësimin e përputhshmërisë ligjore dhe monitorimit të zbatimit të akteve të mëposhtme të KQZ-së:

1. Vendimi nr. 2, datë 30.01.2021 i Komisionit Rregullator për “Miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive”

Kodi Zgjedhor, në nenin 20, pika 1, shkronja ç, parashikon kompetencën e Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të përcaktuar rregullat për metodologjinë e monitorimit të medias, për procedurën e shqyrtimit të raporteve dhe për vendosjen e masave qortuese apo ndëshkimore.

Në kontekstin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve (i.e. 25.03.2021). Dispozitat e Kodit Zgjedhor synojnë të rregullojnë dhe sanksionojnë sjelljen e subjekteve zgjedhore përgjatë kësaj periudhe me qëllim garantimin e integritetit të procesit zgjedhor, garën e ndershme si dhe trajtimin e barabartë të subjekteve zgjedhore. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në cilësinë e institucionit përgjegjës, në nivelin më të lartë të administrimit zgjedhor mbikqyr zhvillimin e fushatës zgjedhore dhe garanton përputhshmërinë e veprimtarisë së subjekteve zgjedhore dhe aktorëve të tjerë (operatorët radiotelevizivë) me dispozitat e Kodit Zgjedhor, veçanërisht nenit 77, 78, 80, 81, 83, 84, 84/1, 85 dhe 92.

Metodologjia e miratuar me anë të Vendimit nr. 2 të Komisionit Rregullator detajon procesin dhe veprimtarinë e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), në kuadër të vëzhgimit të mbulimit të fushatës zgjedhore, nga ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive. Vërehet se metodologjia përcakton qartësisht qëllimet, procedurën, fushëveprimin dhe menyrën e raportimit në KQZ për këtë qëllim. Gjithashtu, në nenin 5 vërehet ndërlidhja e saktë e parashikimeve të Vendimit nr. 2 me përcaktimet e Vendimit të mëparshëm të Komisionit Rregullator, nr. 9, datë 24.12.2020 “Rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të cdo institucionit publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ëndaluar, si edhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, me qëllim shmangjen e transmetimeve të veprimtarive të institucioneve shtetërore, përmbajtja e të cilave është cilësuar si e ndaluar nga KQZ-ja.

Në nenin 3 të Vendimit nr. 2 dt.30.01.2021 (vendimi 2/2021), Komisioni Rregullator paraqet përkufizimin e ofruesve të shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive, i cili buron nga përkufizimi i dhënë në ligjin nr. 97/2013 për “Mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Në nenin 3 të ligjit të përmëndur, ofruesi shërbimi mediatik audioviziv është personi fizik ose juridik, që ka përgjegjësinë editoriale për zgjedhjen e përmbajtjes së shërbimeve të transmetimit audioviziv dhe që vendos menyrën e organizimit të saj. Duke patur parasysh kushtet dhe rrethanat e pazakonta në të cilat po zhvillohet procesi zgjedhor për shkak të kufizimeve dhe ri-organizimit të formave të ndërveprimit si pasojë e pandemisë globale Covid-19, mirëpërcaktimi dhe interpretimi i saktë i fushëveprimit të vëzhgimit mediatik nga ana e KQZ-së janë gjithnjë e më të rëndësishëm.

Nisur dhe nga praktikat e dëshmuara tashmë të organizimit të zgjedhjeve në kushtet e pandemisë, vërehet se subjektet zgjedhore kanë drejtuar vemendjen në publikimin e materialeve në media alternative, përfshirë platformat e mediave sociale, me qëllim komunikimin me grupet e synuara. Së



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



fundmi, platforma *Facebook* ka përfshirë Shqipërinë në listën e vendeve mbi të cilat aplikohen rregullat e transparencës përsa i përket reklamave zgjedhore¹. Për rrjedhojë, është e këshillueshme që KQZ, nëpërmjet mjeteve të vëna në dispozicion të saj nga ligji, të ketë në vëmendje vëzhgimin dhe vlerësimin e një bashkësie të gjërë të operatorëve mediatikë në mënyrë që të garantohet integriteti i procesit zgjedhor, gara e ndershme dhe trajtim i barabartë i subjekteve zgjedhore.

2. Udhëzimi nr. 1, datë 02.02.2021 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për “Caktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurë, emërimin dhe objektin e monitorimit”

Kodi Zgjedhor parashikon në nenin 92/4, pika 2, se *KQZ-ja përcakton me një udhëzim të posaçëm kriteret për përzgjedhjen e monitoruesve, si dhe për objektin e monitorimit. Monitorimi kufizohet me vëzhgimin e respektimit të verifikueshëm, lehtësisht, të detyrimeve të subjekteve zgjedhore për fushatën zgjedhore, duke përfshirë respektimin e ndalimeve dhe kufizimeve të formave të caktuara të fushatës dhe shpërdorimit të burimeve shtetërore.* Në pikën 1 të nenit 92/4, Kodi Zgjedhor parashikohet se caktimi i vëzhguesve kryhet nga KQZ-ja jo më vonë se gjashtë muaj para datës së zgjedhjeve, e cila datoi në 25 Tetor të vitit të kaluar.

Duke patur parasysh se KQZ ja e re u krijua në dt. 05.10.2020, ishte e pamundur objektivisht respektimi i afatit ligjor për caktimin e vëzhguesve të fushatës zgjedhore dhe për monitorimin e shpërdorimit të burimeve shtetërore, jo më vonë se gjashtë muaj para datës së zgjedhjeve. Megjithatë, miratimi i këtij udhëzimi prej Komisionerit Shtetëror që i hap rrugë procesit të përzgjedhjes dhe emërimit të vëzhguesve mund të ishte menaxhuar më herët në kohë, pasi vjen pas gati 3 muaj me vonesë nga data në të cilën këta vëzhgues duhet të ishin emëruar në detyrë.

Në nenin 3 të Udhëzimit nr. 1 parashikohet se *periudha e monitorimit është katër muaj para datës së zgjedhjeve (i.e. 25.12.2020) deri në datën e zgjedhjeve.* Në fushëveprimin e monitorimit përfshihet vëzhgimi i *veprimtarisë së institucioneve publike qendrore/vendore e organeve në varësi të tyre me qëllim parandalimin e veprimtarive të ndaluara apo përdorimin e burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Pjesën VII, Kreu I të Kodit Zgjedhor dhe vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 9, datë 24.12.2020.* Pra, duke vlerësuar se monitorimi i KQZ-së, nëpërmjet caktimit të vëzhguesve, shtrihet të paktën përgjatë periudhës katër mujore përpara datës së zgjedhjeve, në harmoni dhe me shtrirjen kohore të Vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator mbi veprimtaritë e ndaluara, KShH vëren se miratimi relativisht me vonesë i këtij udhëzimi dhe vonesat eventuale në përzgjedhjen dhe emërimin e vëzhguesve, mund të krijojë pengesa në drejtim të një monitorimi të plotë dhe të gjithëanshëm nga KQZ, me anë të vëzhguesve.

Në aspektin përmbajtësor, vërehet se Udhëzimi nr. 1, në nenin 6, adreson saktë kriteret për përzgjedhjen e vëzhguesve në terma të formimit, integritetit dhe paanshmërisë politike duke kërkuar që aplikuesi : (i) *të ketë përfunduar së paku studimet e nivelit 5 të kornizës shqiptare të kualifikimeve (KShK);* (ii) *të jetë i padënuar;* dhe (iii) *të mos ketë qenë në 2 vitet e fundit anëtar i ndonjë partie*

¹[https://apnews.com/article/albania-media-social-media-coronavirus-pandemic-elections-8902bd8d3ee458fa8e7c361d47e751f1;](https://apnews.com/article/albania-media-social-media-coronavirus-pandemic-elections-8902bd8d3ee458fa8e7c361d47e751f1)
<https://www.facebook.com/business/help/2150157295276323#>



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



politike dhe prindërit, bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët madhorë të mos jenë anëtarë të ndonjë partie politike.

Në nenin 11 të Udhëzimit nr. 1 parashikohet se *për zgjedhjet e përgjithshme të datës 25 prill 2021, monitoruesit emërohen jo më vonë se data 15 shkurt 2021 dhe periudha e monitorimit shtrihet deri në datën 25 prill 2021.* Deri në fund të muajit Shkurt, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar Vendimin nr. 100, të datës 23 shkurt 2021, për “*Shpalljen e rezultatit të shortit për përzgjedhjen e monitoruesve për Qarkun e Tiranës dhe Gjirokastrës*”, në të cilën miratohen 16 vëzhgues për qarkun e Tiranës dhe 2 vëzhgues për qarkun e Gjirokastrës. Po në këtë vendim, Komisioneri shprehet se *përsa i përket qarqeve të tjera, duke qenë se pjesëmarrja ka qenë më e ulët sesa numri për monitorues që duhet për secilin qark, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do nxjerri një njoftim të dytë lidhur me pjesëmarrjen që nevojitet për secilin qark për të plotësuar vakancat e mbetura.* Për sa më sipër, këshillohet të procedohet me ritme më të përshtatshme për të finalizuar procesin e përzgjedhjes dhe emërimit të vëzhguesve me qëllim zhvillimin e monitorimit përgjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Rëndësia e vëzhgimit të sjelljes së subjekteve zgjedhore para dhe përgjatë fushatës zgjedhore reflektohet dhe në faktin se janë evidentuar raste të shpërndarjes së materialeve propagandistike përpara fillimit të fushatës zgjedhore, çka ka nxitur KQZ-në të dalë në njoftim me shtyp me datë 11.02.2021, publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së, nëpërmjet së cilës rikujtojnë se të tilla materiale janë të lejuara vetëm gjatë fushatës zgjedhore dhe se subjektet politike dhe kryetarët e bashkive duhet të plotësojnë detyrimet e përcaktuara nga Kodi Zgjedhor.

3. Vendimmarrjet e KQZ-së për shqyrtimet e kërkesave të partive politike për regjistrim si subjekt zgjedhor në Zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021 dhe të kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit për Zgjedhjet për Kuvend

Kodi Zgjedhor në nenin 64, pika 1, parashikon se *çdo parti politike duhet të paraqesë kërkesën për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ jo më vonë se 70 ditë përpara datës së zgjedhjeve (i.e. 15.02.2021).*

Nëpërmjet njoftimeve për shtyp, publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së, të datave 05.02.2021, 11.02.2021, 15.02.2021 dhe 22.02.2021, vërehet se janë depozituar gjithsej 49 kërkesa për regjistrim si subjekte zgjedhore dhe është miratuar ngritja e 8 komiteteve nismëtare për paraqitjen e kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore të Qarkut Shkodër, Berat, Tiranë, Dibër, Lezhë dhe Gjirokastrë. Ndër to, KQZ, nëpërmjet vendimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ka miratuar kërkesat përkatëse dhe ka regjistruar si subjekte zgjedhore në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, 46 parti politike dhe ka refuzuar për mungesë të dokumentacionit, 3 kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor.

Nga vendimet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve vërehet se kërkesat për regjistrim si subjekt zgjedhor janë dorëzuar në KQZ në përputhje me afatet ligjore, përgjatë periudhës 12.01.2021 deri në datën 15.02.2021.



4. Mungesa e vendimmarrjes së KQZ-së për administrimin e procesit lidhur me votimin nga jashtë vendit të diasporës shqiptare

Në funksion të garantimit të së drejtës kushtetuese të votës për shtetasit shqiptarë që përmbushin kriteret ligjore, Kodi Zgjedhor, pas ndryshimeve që pësoi, parashikon në nenin 24, pika 1 se *KQZ-ja udhëheq dhe mbikëqyr procesin për përgatitjen e kushteve dhe zbatimin e masave që mundësojnë votimin nga jashtë vendit në zgjedhjet për Kuvendin, për zgjedhësit që kanë vendbanimin e përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kanë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile adresën e vendbanimit të përhershëm jashtë vendit dhe kërkojnë nga KQZ-ja që të pajisen me dokumentacionin e votimit nga jashtë.* Një ndër risitë kryesore të Kodit Zgjedhor ishte pikërisht parashikimi për ushtrimin e të drejtës së votës jashtë territorit të Shqipërisë, për shtetasit me banim të përhershëm jashtë vendit. Megjithatë, sikurse Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka sjellë në vëmendje përgjatë periudhës së diskutimeve të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, ligjvënësi nuk ka parashikuar një kornizë të plotë ligjore që rregullon me qartësi dhe pa ekuivoke të drejtën e votimit nga jashtë vendit për zgjedhësit me vendbanim jashtë territorit. Vakumi ligjor në Kodin Zgjedhor e vendos në vështirësi KQZ-në, lidhur me zbatimin e procesit të votimit nga jashtë. KQZ nuk mund të marrë tagrat e pushtetit legjislativ dhe rrjedhimisht nuk mund të adresojë të tilla boshllëqe ligjore me miratimin e akteve nënligjore.

Pavarësisht nga vështirësitë, KQZ, me datë 31.10.2020, ngriti një grup pune për të identifikuar mënyrat e mundshme për të rregulluar dhe vendosur në jetë, procesin e votimit nga jashtë vendit. Me datë 31.12.2020 është publikuar në media raporti i parë i grupit të punës për vlerësimin e mundësisë për votimin nga jashtë vendit, në të cilin parashtrohen dy mënyra për të realizuar procesin e regjistrimit dhe përpilimit të listave të zgjedhësve me banim jashtë vendit. Procesi i regjistrimit parashikohet të realizohet nëpërmjet një sistemi elektronik të administruar nga AKSHI ose vetë KQZ. KShH ka përcjellë mendimet e tij lidhur me propozimet e paraqitura në raport, në të cilat shpreh mbështetjen për përdorimin e sistemit elektronik. Megjithatë, realizimi në praktikë i ushtrimit të së drejtës së votës nga shtetasit Shqiptar me vendbanim të përhershëm jashtë vendit ndesh në mënyrë të veçantë vështirësi për shkak të mungesës së të dhënave të adresave (për vendbanimin e përhershëm jashtë vendit) të këtyre shtetasve në Regjistrin e Gjendjes Civile. Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në bazë të vëzhgimit të kryer gjatë muajit tetor në 11 njësi administrative të qarkut Tiranë dhe njësitë përkatëse të gjendjes civile, ka evidentuar se regjistrat e gjendjeve civile nuk përmbajnë adresat e vendbanimit të përhershëm të shtetasve shqiptar me banim jashtë vendit.

Për të adresuar çështjen e të dhënave lidhur me adresat, raporti i Grupit të Punës së ngritur nga KQZ përmban referencë të Ligjit nr. 15/2016 për *“Identifikimin dhe regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë”* dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 915, datë 4.11.2020 për *“Përcaktimin e rregullave për njoftimin e detyrimit për vetëdeklarim të adresës nga shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të procedurës së plotësisimit e të dorëzimit të formularit të vetëdeklarimit dhe të dokumenteve shoqëruese të tij, administrimin e tyre nga autoritetet përgjegjëse, si dhe të shërbimeve të tjera që ofrojnë këto autoritete ndaj shtetasve.* Tërheq vëmendjen faktin se kjo VKM është miratuar në nëntor të vitit të kaluar, pra me 4 vite vonesë nga miratimi i ligjit nr.15/2016, duke krijuar përshtypjen se është miratuar për të adresuar pikërisht vakumin ligjor dhe institucional që mundëson identifikimin e adresave të emigrantëve shqiptarë.



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



VKM parashikon në pikën 9 se *autoritetet përgjegjëse i ofrojnë shtetasit shqiptar, në adresën e vetëdeklaruar e të konfirmuar, këto shërbime: (ndër të tjerash në gjermën b) ushtrim të së drejtës së votës, në zbatim të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë*. Rregullimi i procesit të votimit nga jashtë, sipas VKM-së, kryhet nëpërmjet akteve të posaçme normative të KQZ-së dhe, për rrjedhojë, gjykohet se aktet e referuara në raportin e grupit të punës, të cilat janë në funksion të një tjetër qëllimi, nuk shërbejnë për të adresuar apo zëvendësuar vakumin apo boshllëkun ligjor në Kodin Zgjedhor.

Në pikën 2 të nenit 24 të Kodit Zgjedhor parashikohet se *votimi nga jashtë vendit organizohet dhe administrohet nga KQZ-ja në të gjithë komponentët e tij, pasi Rregullatori të ketë miratuar të gjitha aktet nënligjore që kërkohen për votimin nga jashtë vendit, sipas këtij ligji*. Gjithashtu, Kodi Zgjedhor dikton afatin ligjor brenda të cilit aktet nënligjore, përfshirë aktet e referuara në dispozitën e sipërcituar, duhet të miratohen nga KQZ. Neni 184 i Kodit Zgjedhor parashikon se *ngarkohet KQZ-ja të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e tij*. Ligji nr. 101/ 2020 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008*”, i publikuar në Fletoren Zyrtare në datën 04.08.2020, sipas nenit 48, hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare (i.e. 19.08.2020). Rrjedhimisht, aktet nënligjore të cilat rregullojnë procesin e votimit nga jashtë vendit duhej të ishin miratuar brenda datës 19 Shkurt 2021.

Sa më sipër, administrimi dhe realizimi i votimit nga jashtë vendit është një proces i vështirë dhe delikat. KSHH me keqardhje vëren se ky proces nuk gjeti adresimin dhe rregullimin e duhur në kuadër të reformës zgjedhore, megjithatë inkurajon KQZ-në që të marrë masat e nevojshme, bazuar në Kodin Zgjedhor, për të jetësuar, për aq sa është e mundur, këtë proces në praktikë.

5. Shqyrtimi i kallëzimeve për shpërdorim të burimeve shtetërore

Kodi Zgjedhor në nenin 91, pika 1 parashikon se *me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia*. Në zbatim të dispozitave të Kodit Zgjedhor, Komisioni Rregullator ka miratuar Vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 për “*Rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve*”, në të cilin detajohen rregullat e raportimit nga ana e institucioneve shtetërore, vlerësimi i shkeljeve të mundshme dhe sanksionet përkatëse.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka shqyrtuar disa denoncime të paraqitura nga subjekte të interesuara (*parti politike, shoqëri civile*) lidhur me veprimtarinë e titullarëve të institucioneve shtetërore dhe deputetë të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Posaçërisht, KQZ ka publikuar, ndër të tjera, Vendimin nr. 101 dhe Vendimin nr. 102, datë 25.02.2021, ndaj dy deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë dhe Vendimin nr. 46, datë 9.02.2021, ndaj Kryetarit të Bashkisë Tiranë.

Për sa i përket kallëzimeve ndaj dy deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë lidhur me aktivitetet e zhvilluara në hapësirat e shkollave të mesme, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në vendimet e tij,



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



INSTITUTE FOR POLITICAL STUDIES
www.isp.com.al



CIVIL
RIGHTS
DEFENDERS

përmënd se rrethi i subjekteve ndaj të cilëve aplikohen kufizimet e Vendimit nr. 09 nuk përfshin deputetët, sipas nenit 3, pika 2. Më tej, Komisioneri analizon kushtet për të cilësuar veprimtaritë e kallëzuara si veprimtari publike. Në kuptimin e nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 2, gërma b) të Vendimit nr. 09, veprimtari publike konsiderohen veprimtaritë të cilat: (i) janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo medias; (ii) ose kanë në agjendë informimin e publikut.

Në Vendimin nr. 46 ndaj Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përcakton karakterin publik të veprimtarisë në fjalë në bazë të njoftimit të dërguar nga zyra e shtypit e bashkisë në drejtim të mediave (*operatorëve televizivë*). Pra, sic Komisioneri vëren, prania apo jo e medias gjatë zhvillimit të veprimtarisë nuk është përcaktuese për cilësimin e karakterit publik të veprimtarisë, përse kohë vërtetohet qëllimi i informimit të publikut nëpërmjet medias. Pavarësisht se përfaqësuesi ligjor i të paditurit sjell në vëmëndje dhe argumenton se përmbajtjet audiovizive të publikuara në rrjete sociale nuk i shërbejnë përcaktimit të karakterit publik të veprimtarisë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në Vendimin nr. 46, anashkalon kryerjen e një analize shteruese dhe qartësuese të përfshirjes apo ndikimit të përmbajtjeve audiovizive të publikuara në rrjete sociale për qëllim të përcaktimit të karakterit publik sipas kriterëve të parashikuara në ligj.

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, në Vendimin nr. 06, datë 16.02.2021, për “*Shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 03, datë 11.02.2021 të Zotit Erion Veliaj ndaj Vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 46, datë 09.02.2021*” gjykon të arsyeshme të saktësojë se qëllimi i informimit të publikut, element i cili e bën një veprimtari të ketë karakter publik, përcaktohet vetëm nëpërmjet materialit të komunikuar medias nga zyra e shtypit, jo nëpërmjet publikimit të përmbajtjeve audiovizive të së njëjtës veprimtari në platformën sociale Facebook. KAS vëren se, *ky saktësim është i rëndësishëm, sepse denoncimet e ngjashme në të ardhmen, kërkimin e provës duhet t’u orientojnë në këtë drejtim*, duke vendosur kështu një precedent në interpretimin e karakterit publik të veprimtarive. Vërehet se vendimet e dy organeve të KQZ-së, përkatësisht Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, reflektojnë interpretime të ndryshme të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe të Vendimit nr. 09 të Komisionit Rregullator.

Në linjë me argumentimin e mëparshëm të KShH-së, vlerësohet se platformat informuese apo mediatike të rrjeteve sociale nuk duhet të qëndrojnë jashtë vëmëndjes së KQZ-së për qëllim të monitorimit të sjelljes dhe veprimtarisë së institucioneve shtetërore dhe titullarëve të tyre. Përfshirja e medias sociale në përkufizimin e gjërë të medias mbështetet dhe nga raporti përfundimtar i misionit të OSBE/ODIHR për vëzhgimin e Zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2017, në të cilin vëren se *televizioni (TV) është burimi kryesor i informacionit politik, ndërsa portalet online dhe media sociale po e zëvendësojnë me shpejtësi median e shkruar*². Vlerësohet se institucionet dhe organet përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor duhet t’i përgjigjen përshtatshëm rrethanave dhe realitetit në të cilin zhvillohen ky proces në kushtet e pandemisë globale si rezultat i masave parandaluese të transmetimit të virusit Covid-19. Ky vlerësim duhet të bazohet në standartet dhe praktikën më të mira

² OSCE Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, Raporti përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR-it për vëzhgimin e Zgjedhjeve për Kuvendin, 28.09.2017, Varshavë, fq. 17.



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



ndërkombëtare, si dhe rekomandimet e adresuara nga OSBE/ODIHR, i cili në vëzhgimin e zgjedhjeve të fundit për Kuvend ka përfshirë median sociale në fushëveprimin e vëzhgimit të medias³.

³ *Ibid, fq.18: MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it monitoroi një spektër të gjerë subjektesh mediatike me analiza sasiore dhe cilësore të mbulimit politik të fushatës prej tyre gjatë transmetimeve në fashën më të ndjekur orare (nga ora 18:00 deri në orën 24:00) për pesë kanale TV (transmetuesi publik RTSH dhe katër kanale private: ABC News, Top Channel, TV Klan dhe Vizion Plus), një gazetë të përditshme (Panorama) dhe tre portale online (balkanweb.com, gazetatema.net dhe syri.net).*